



Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.12.11.2019, Ora 10.00

Drejtojnë mbledhjen:

**Damian Gjikhuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë të Komisionit të
Posaçëm të Reformës Zgjedhore**

Rendi i ditës:

Diskutimi i draftit të tretë të përpunuar nga ekspertët e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore

Marrin pjesë:

Damian Gjikhuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Nimet Musaj, Korab Lita, Adriatik Alimadhi, Adnor Shameti dhe Jurgen Çyrbja.

Mungojnë:

Alket Hyseni dhe Bashkim Fino.

HAPET MBLEDHJA

Damian Gjicknuri – Mirëmëngjesi!

Sot, sipas rendit të ditës që kemi përcaktuara në mbledhjen e shkuar do të paraqitet nga ekspertët pjesa e tretë e propozimeve për Kodin Zgjedhor që ka të bëjë me çështjet e zonave të administrimit zgjedhor, disa thjeshtësime të procedurave të votimit, si dhe kapitulli që ka të bëjë me ankesat. Gjithashtu, janë edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë direkt me rekomandimet, të cilat janë parë të nevojshme nga ekspertët që duhet të ndërhyhet në amendimet e Kodit Zgjedhor.

A ka diçka për procedurë?

Urdhëroni!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti kryetar!

Që në fillim të punës së këtij komisioni kemi depozituar me firmë të 39 deputetëve të opozitës në parlament një kërkesë që është tashmë objekt i punës së këtij komisioni për ndryshimin e sistemit zgjedhor. Pra, ne kemi një propozim konkret për ndryshimin e sistemit zgjedhor për zgjedhjet e pushteti qendror në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Sekretarja t'ua vërë në dispozicion nga një kopjo të draftit për çdo anëtar!

Faleminderit!

Damian Gjicknuri - Faleminderit!

Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë kam një sugjerim. Meqenëse në çdo mbledhje po vijnë ndryshime të neneve të ligjit ekzistues, do të vlerësoja që ekspertët të na bënin një prezantim të risive që sjell ndryshimi në raport me Kodin Zgjedhor në fuqi dhe nëse këto ndryshime janë në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it.

Faleminderit!

Damian Gjicknuri – Faleminderit!

Urdhëroni!

Ralf Gjoni - Faleminderit!

Të nderuar bashkëkryetarë,

Të nderuar kolegë,

Do të doja të qartësonim metodologjinë e punës së këtij komisioni, sepse mendoj se ndoshta e kemi filluar së prapthi. Në një nga mbledhjet e mëparshme, gjatë prezantimit të draftit nga ekspertët, kërkoja arsyetimin pse dhe sipas cilit model është modeluar drafti mbi

të cilin ne po punojmë dhe kam përshtypjen se ne kemi filluar mbi një premisë të gabuar të punës së këtij komisioni, ku na sillet një draft i parapërgatitur dhe ne diskutojmë mbi këtë draft. Në fakt, unë mendoj se ne duhet të kishim rënë një herë dakord si përfaqësues politikë këtu në komision dhe pastaj t'u kërkonim ekspertëve të draftonin atë dakordësi politike që kemi.

Më konkretisht, unë u kam kërkuar para dy-tri mbledhjeve ekspertëve se si do të ishte modeli rumun ose si mund të aplikohet modeli rumun në Shqipëri. Përse ekspertët të mos përgatisin një pasqyrë krahasimore me një, dy ose tre modele, që ne t'i shohim dhe t'i diskutojmë? Besoj se kështu ne do të kemi mirëkuptim mjaftueshëm për të gjetur atë infrastrukturë dhe arkitekturë zgjedhore që i duhet Shqipërisë.

Pra, unë mendoj se ne duhet të biem njëherë dakord për metodologjinë e punës, para se të na ushqehet një draft i parapërgatitur dhe të na kërkohet ta votojmë. Ne nuk do të votojmë asnjë draft, i cili nuk është dakordësuar më parë politikisht nga ne dhe pastaj t'u jepet ekspertëve.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri - Faleminderit!

Së pari, në lidhje me çështjen e sistemit që u propozua këtu, falënderoj përfaqësuesin e opozitës që më në fund solli një propozimin konkret për çështjen e sistemit zgjedhor.

Ka biseduar me bashkëkryetarin që në momentin që ky propozim do të vinte në tryezën e komisionit. Ne do të caktojmë një datë për zhvillimin e një mbledhjeje në lidhje me çështjen e sistemit propozoj që me atë rast, përveç propozimit që ju keni, meqenëse çështja e sistemit është një çështje që ka një gamë të gjerë aktorësh dhe interesi është shumë më i madh, përtej kësaj tavoline, për sistemin të vinin edhe organizata të tjera apo edhe parti të ndryshme politike, të cilat mund të kenë propozimet e tyre për sistemin dhe besoj këtu nuk do të kemi ndonjë kundërshti, sepse e kemi thënë se çështja e sistemit, aq më tepër që ka gjasa të jetë çështje kushtetuese, do të kërkojë një gjithëpërfshirje nga gjithë aktorët, edhe përtej kësaj salle.

Për ato çështje që ngriti zoti Gjoni, ne e kemi sqaruar edhe një herë dhe besoj se kjo është metodologjia normale e punës. Ne nisemi nga eksperiencia e krijuar tashmë, jo vetëm në punën e mëparshme të Komisionit të Reformës Zgjedhore, por edhe e traditës të menaxhimit të zgjedhjeve në Shqipëri ku ekspertët, nisur nga intuita e tyre profesionale, por bazuar edhe në rekomandimet që kanë ekspertët e huaj, paraqesin disa propozime. Këto janë propozime nuk janë mendime as të PS-së, as të anëtarëve të tjerë të parive në këtë tavolinë.

Nëse ne kemi kundërshti apo kemi propozime alternative në atë draft apo siç kemi bërë edhe me shoqërinë civile, ne jemi të lirë t'i miratojmë. Pra, ne nuk biem dakord që të ngremë një sistem nga hiçi. Unë mendoj që metodologjia që kemi nuk ka asgjë të keqe, secili është i lirë të propozojë cdo lloj gjëje që e mendon se e përmirëson çështjen e administrimit zgjedhor. Ne akoma nuk i kemi hedhur në votim propozime, që do të thotë se edhe ne kemi mosdakordësinë tonë, edhe ne kemi probleme me njëri-tjetrin për të kuptuar më mirë dispozitat, për të shfaqur dyshimet tona, apo për ta përmirësuar atë draft.

Në këtë rast unë nuk mendoj se ka vend për të vazhduar me debat.

Ralf Gjoni - Faleminderit!

Jam shumë dakord me logjikën tuaj. A ka mundësi që propozimi im për të parë arkitekturën e modelit rumun, i cili mendoj se do të ishte perfekt për terrenin shqiptar, të aplikohet dhe a kemi dakordësi? A është e mundur t'i kërkojmë ekspertëve të përgatisin edhe një draft të dytë, modeluar sipas Rumanisë, që është një vend nga i cili mund të mësojmë në shumë aspekte dhe le t'i debatojmë draftet si modele?

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Po u drejtohem ekspertëve për të na e gjetur modelin rumun, por nuk mendoj se kemi burime dhe kohë të nevojshme që të rimodelojmë apo të rishkruajmë një projektligj bazuar në një model, por nëse ne kemi mundësi që disa pika të modelit rumun t'ua shpërndajmë të gjithë anëtarëve.

Ndoshta ekspertët mund të bëjnë një takim të veçantë për modelin rumun dhe një arkitekturë të përgjithshme mund t'ua shpërndajmë të gjithë anëtarëve. Nëse ne gjykojmë se është modeli i duhur, mund t'u japim detyrë ekspertëve për ta bërë.

Myslim Murrizi – Nuk e di nga e ka pikënisjen Ralfi për rumunët.

(Diskutime pa mikrofon)

E gjithë Republika jonë ka 127 parti politike të regjistruara, nga të cilat 66 parti politike kurrë nuk janë regjistruar në zgjedhje prej ditës që është prishur kooperativa (rrinë kot). Nga 61 parti politike që janë regjistruar në zgjedhje, vetëm 15 parti politike kanë kapërcyer pragun 1%.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, 46 parti të tjera nuk e kanë kaluar pragun. Edhe një fakt tjetër interesant është se 60 parti politike, gjatë gjithë zgjedhjeve, nga 31 marsi '91, kanë marrë më pak se numri i firmave që kanë për t'u krijuar si parti. Kanë marrë 3 mijë firma në gjykatë për t'u krijuar dhe 60 parti nuk i kanë kaluar 3 mijë vota.

Në vitin 2013 partia në transfertë e Xhuvelit, para se të kalonte te Duka, ka marrë 2632 vota në të gjithë Shqipërinë. Gjithsesi, unë do t'ju jap tabelën me të gjitha zgjedhjet lokale dhe qendrore, nga 31 marsi '91 me kryetar Rexhep Mejdani deri në fund me kryetare Lefterinë.

(Diskutime pa mikrofon)

Duhet parë ligji për partitë politike!

Ajo parti që nuk merr votat e atyre që kanë firmosur dhe ajo parti që nuk merr pjesë të paktën në dy palë zgjedhje, të mos quhet më parti.

Faleminderit!

Damian Gjijnuri – Statistika ishte shumë interesante, madje dua të them se këto parti dalin në skenë vetëm kur diskutohet ligji për partitë politike ose reforma zgjedhore. Kjo është e vërtetë.

Adriatik Alimadhi – E para, zoti Murrizi, për të sqaruar pak, nuk e pata me statistikat që ka nxjerrë KQZ-ja, por zakonisht për këto vite grupet e numërimit me KZAZ-të kanë bërë kërdrinë.

E dyta, nëse keni kërkesa për të suprimuar me ligje, siç keni vazhduar edhe më parë, për t'i hequr partitë nga skena politike, por më duket sikur po shkoni në një neodiktaturë. Pra, hiqini të gjitha partitë dhe ngelni vetëm ju të dyja, se ju të dyja partitë keni kapur gjithë sistemin, administratën...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju keni kapur gjithë sistemin. 160 mijë vende pune që keni, për nga 4 vota, e keni bërë llogarinë. Pra, kjo është vjedhja më e madhe. Unë kam kërkuar në këtë komision, pavarësisht ndryshimit të sistemit, mënyrën e financimit. Ju që jeni parti të mëdha, hiqeni mënyrën e financimit nga shteti dhe hajdeni të futemi në zgjedhje pa asnjë mundësi (se ju keni administratën, por njëkohësisht edhe paratë, sepse edhe komisionerët dhe grupet e numërimit ju i paguani nga taksat e shtetit). Hajdeni ta heqim edhe mundësinë e financimit dhe ta shohim se si dilni në zgjedhje, i fitoni apo i vidhni.

Damian Gjijnuri – Ishte propozim interesant ky. Kur të vijë momenti i diskutimit do të doja që ju të thoni se partitë politike të mos marrin asnjë financim nga shteti.

Adriatik Alimadhi – E kam thënë edhe në takimin që organizoi ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, Boshard.

Damian Gjijnuri - Kalojmë te prezantimi i projektit nga ekspertët.

Viktor Gumi - Faleminderit!

Aktualisht, ne kemi paraqitur përpara jush pjesën e tretë, që konsiderohet si pjesa finale. Fokusi kryesor i ndryshimeve që kemi bërë ka qenë fokus i një natyre teknike, pra është riformuluar pjesa e infrastrukturës zgjedhore, i procedurës së votimit, i nxjerrjes së rezultatit dhe pastaj i procedurës së shqyrtimit administrativ dhe të shqyrtimit gjyqësor të mosmarrëveshjeve gjyqësore.

Kemi bërë një riformatim dhe një riformulim, i cili prek së pari ndryshimet e terminologjisë që lindin në këtë aspekt, sepse është thjesht logjikë e neneve të mëparshme që kërkojnë ndryshimin e këtyre neneve.

Nga ana tjetër, përderisa kemi kaluar në një filozofi të re, nga një administrim politik në një administrim të një natyre tjetër, kjo kërkon edhe një riparje të këtyre dispozitave me këndvështrimin e reduktimit të masës që është parashikuar për secilën prej tyre dhe detajimit për secilën prej tyre.

Dispozitat e Kodit Zgjedhor aktual në fuqi janë ngritur mbi bazën e atij balancimi, mbi bazën e asaj mënyre veprimi.

Ne propozojmë mënyrë tjetër veprimi, që do të thotë edhe rixhediteti dhe fleksibiliteti i tekstit ligjor duhet të rishikohet në këtë drejtim.

Kemi gjykuar, nisur edhe nga diskutimet në komisionin e mëparshëm, përpara konstituimit të këtij komisioni dhe vijimit të punët prej këtij komisioni, që teksti i Kodit Zgjedhor është me shumë detaje, ndërkohë që edhe tradita është krijuar në një farë mënyre nga struktura e zgjedhjeve në Shqipëri dhe vlerësojmë se është e nevojshme që ai të mbajë natyrën e kodit, natyrën e një gjuhe normative, me terma parimorë të përgjithshëm, ndërkohë detajet teknike nuk kanë pse të gjenden në kod, por këto të kalojnë në aktet nënligjore përkatëse, të cilat do të miratohen nga komisionet, si kundër e përmendëm në fillim në dispozitat përkatëse nga rregullatori.

Pra, përgjithësisht ne kemi marrë nen për nen ekzistencën e neneve të kodit aktual dhe jemi mundur t'i rishikojmë në kuadër të terminologjisë në përputhje me pjesën aktuale të pjesës pararendëse të Kodit Zgjedhor.

Së dyti, duke qenë se kemi kaluar në një mekanizëm të ri, ta zhveshim këtë kod nga teprimet e natyrës teknike, duke mbajtur në të vetëm ato parime të përgjithshme të karakterit normativ.

Është bërë një redaktim i dispozitave përkatëse, por thelbi i tyre ka ngelur i njëjtë. Për shembull, te zonat e administrimit zgjedhor është bërë vetëm një redaktim duke hequr ato, që ne gjykojmë se janë pjesë të tepërta dhe duke e formatuar në një nen të vetëm, por thelbi i zonës së administrimit zgjedhor qëndron përsëri i njëjtë.

Te zona e qendrës së votimit ne përsëri kemi mbajtur të njëjtat kritere që janë te kodi aktual. Nuk është se kemi bërë ndonjë ndryshim të veçantë, me përjashtim të stilistikës dhe teknikës gjyqësore për këtë pikë.

Besoj se nuk e nevojshme të kaloj nen për nen, sepse është e njëjta ide.

(Diskutime pa mikrofon)

Në radhë të parë është dispozita për transparencën. Gjithë procesi, sikundër e kemi parashikuar edhe në pjesën aktuale të mëparshme, ku kemi thënë se do të fuqizojmë dispozitat për transparencën, ky proces, për sa kohë ushtrohet edhe nga organet e tjera të administratës zgjedhore, partive politike, subjekteve zgjedhore, përfaqësuese ju është dhënë akses në çdo fazë të procesit dhe marrje dokumentacioni për çdo gjë që prodhojnë komisionet e qendrave të votimit ose NJAZ-të.

Kjo është një nga ato pika, të cilat, ndryshe nga radhët e para, është parashikuar këtu, sepse subjektet zgjedhore, partitë politike nuk është se i kishin përfaqësues dhe vëzhgues në atë pikë, sepse ato ishin vetë subjekte zgjedhore, kishin anëtarë komisionesh.

Damian Gjikhuri – Kur thoni “transparenca” është përtej, sepse aksesit në materialet zgjedhore gjatë fazave të votimit dhe më vonë ka qenë edhe tani i garantuar, pra procesverbalet. Po thua pas shpalljes së rezultatit?

Viktor Gumi – Kjo është edhe përpara, sepse në momentin që ne kemi bërë administratën zgjedhore, këtu edhe përfaqësuesit e partive politike kanë rol për të luajtur. Më përpara nuk e kishin sepse ishin anëtarë të komisioneve, ndërkohë sot do të ketë administratë zgjedhore.

Së pari, përballë administratës zgjedhore do të qëndrojnë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, përfaqësuesit e partive politike dhe është e sanksionuar që çfarëdo dokumentacioni që do të prodhohet nga këto institucione, një kopje e tij do të jetë e vlefshme dhe do t'i dorëzohet menjëherë edhe këtyre përfaqësuesve.

Së dyti, është vendosur kontrolli aposteriori i fletëve të votimit dhe i materialeve të votimit.

Në fillim kemi sanksionuar në tekstin e dispozitës, që është e detyrueshme me KQZ, me iniciativën e saj, në një numër të përcaktuar qendrash votimi ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, të bëhet e mundur hapja e kutive të materialeve zgjedhore dhe e fletëve të votimit. Kjo përjashton ato raste, kur këto hapje kutish kanë kaluar në procesin e rinumërimit sipas procesit ankimor, sepse është gjë e kotë që të përsëritet dy herë një gjë e tillë.

Ky sistem do të prodhojë dhe do të kontrollojë punën e administratorëve zgjedhorë dhe do të shërbejë, gjithashtu, edhe për vlerësimin e këtyre administratorëve zgjedhorë.

Nga ana tjetër, procesi për hapjen e kutive të votimit do të fillojë vetëm pasi të jetë ezauruar e gjithë procedura administrative dhe shpallja e rezultatit.

Ndërkohë kemi sanksionuar në dispozitën përkatëse, që pavarësisht se cili do të jetë rasti i shqyrtimit dhe konkludimet që mund të ketë në përfundim të procesit të verifikimit, kjo nuk mund të shërbejë, qoftë drejtpërdrejt, qoftë në mënyrë indirekte, si bazë ligjore për anulimin e rezultatit zgjedhor. Rezultati zgjedhor do të anulohet vetëm nëpërmjet një procedure ankimore. Në qoftë se mbyllet procedura ankimore, shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, konstituohen organet, kjo është një procedurë tjetër vlerësimi, së pari për të kontrolluar punën që kemi bërë dhe, së dyti, për t'i dhënë një mjedis më të hapur, nisur edhe nga praktikat e mëparshme që kemi pasur për këto çështje, të hapjes së kutive, të verifikimit të rezultateve dhe diskutimeve të një natyre të tillë politike.

Subjekte zgjedhore kanë të drejtë ta kërkojnë këtë gjë. Do të ketë një tarifë përkatëse, sepse është një punë administrative që kryhet nga shteti dhe do të duhet ta paguajnë tarifën përkatëse për këtë shërbim që ka shteti.

Damian Gjijnuri – Transparenca post-zgjedhore është një pjesë shumë e rëndësishme.

Sa parashikohet *sampling*-u?

Viktor Gumi – Këtë ia kemi lënë në dorë ta verifikojë rast pas rasti, nuk është e përcatuar këtu në tekstin e kodit.

Damian Gjijnuri – Mos duhet të vëmë një minimum që të quhet “*sampling*”? pra, do të themi 1% e zonave zgjedhore, duhet vënë një minimum, sepse vihet i gjithë presioni te KQZ-ja.

Këto do të shërbejnë si indicie apo si materiale, prova për të bërë një kallëzim penal në rastin e shkeljes?

Viktor Gumi – Patjetër. Procesi penal është në korsinë e tij, pra shërbejnë si prova dhe kjo është e hapur si rrugë dhe, gjithashtu, kjo do të shërbejë si provë për vlerësimin e personelit përkatës, performancës së administratorëve zgjedhorë që më vonë ata t'i nënshtrohen ndëshkimit që parashikon kodi për këtë pikë apo ligji “Për nëpunësin civil”, sipas pikës që ju kemi thënë.

Pra, njëkohësisht, përvës kësaj mënyre, ne shikojmë edhe performancën që ata persona kanë bërë për këtë gjë, në procesin e numërimit të votave dhe kështu me radhë.

(Diskutime pa mikrofon)

Subjektet që marrin pjesë në zgjedhje kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për hapjen e kutive zgjedhore të caktuara dhe shqyrtimin e materialeve dhe fletëve të votimit, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar.

Së dyti, kemi bërë një raportim. Jemi përpjekur, nisur edhe situata aktuale në Kosovë, por edhe nga diskutimet që kemi pasur me grupet e ekspertëve dhe vështirësi të tjera, të vendosim, për aq sa parashikohet në Kodin Zgjedhor, një raport marrëdhënieje informimi midis prokurorisë për hetimin e krimeve me një natyrë zgjedhore dhe informimin publik që duhet të bëjë KQZ-ja, pra, detyrimin KQZ-së për të kërkuar informacion nga prokuroria, prokuroria për të dhënë informacion, duke ruajtur, sipas Kodit të Procedurës Penale, sekretin hetimor për çështje penale me natyrë zgjedhore dhe ky informacion t'i vihet në dije publikut për këtë periudhë, para, gjatë dhe pas zgjedhjeve.

Pra, thjesht detyrë për të informuar, për të krijuar idenë se kjo po ecën si hetim, po vazhdon, po bëhet transparente puna e prokurorisë. Të paktën, ky ka qenë qëllimi ynë, krijimi i një marrëdhënie informimi për aq sa mund të vendosë Kodi Zgjedhor.

Informimi i publikut pa prishur sekretin hetimor vetëm i bën mirë procesit.

Ka edhe ndryshime emërtesash KZAZ, KQV dhe kështu me radhë. Është parashikuar edhe rasti i ankimit administrativ, i cili është pothuajse në të njëjtat linja me ankimin administrativ që kemi sot, nuk është më KQZ, por është në kasë, sipas ankimit administrativ. Kemi parashikuar nga ankimi administrativ kalimin në ankimin zgjedhor, shqyrtimin zgjedhor të mosmarrëveshjeve. Këtu kemi bërë një ndryshim, në kuptimin e një dallimi mbi bazën e diskutimeve që kemi bërë më parë. Kemi diskutuar dhe kemi thënë se përjasja jonë është një kod me karakter normativ që ta shtrijmë ndër vite dhe kemi menduar që mosmarrëveshjet gjyqësore, në kuptimin më klasik, janë domen jo më i Kolegjit Zgjedhor në natyrën që funksionon dhe operon sot, por do të jetë domein i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Ata janë gjykatë administrative, është punë e përditshme me të cilën gjykojnë mosmarrëveshjet administrative dhe kjo në kuptimin *par excellence* është çështje administrative, sepse aktet që prodhon nga komisioni më i vogël te komisioni më i lartë janë akte administrative. Pra, në kuadrin më të përgjithshëm ato do të shqyrtohen në planin afatgjatë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit funksionon sipas ligjit të saj organik, i cili parashikohet se do të jetë i vlefshëm, gjithashtu, edhe për këtë pjesë.

Ne kemi bërë vetëm disa ndërhyrje, të cilat kanë të bëjnë me afatet, jo sipas ligjit tradicional, por kemi gjykuar afate, të cilat duhet të jenë të shkurtuara dhe, së dyti, jo

nëpërmjet një trupe, kur vendoset relatori dhe pastaj dihet anëtarësia e trupit për shkak se janë trupa gjykues që kryetari i gjykatës vendos në fillim të vitit. Caktohet relatori, ndërkohë edhe anëtarët e tjerë të trupës gjykuese që do të shqyrtojnë mosmarrëveshjet zgjedhore, nuk duhet të jenë të ditur paraprakisht. Ata duhet të jenë të caktuar me short dhe trupi gjykues në këtë rast përdoret në dy formate: formati me 3 gjyqtarë për mosmarrëveshjet zgjedhore më natyrë të zakonshme dhe formati me 5 gjyqtarë për mosmarrëveshjet zgjedhore me karakter normativ, që do të nxjerrë KQZ-ja dhe për gjykimin e përpushtshmërisë së tyre me përcaktimin e Kodit Zgjedhor.

Kemi vendosur në funksion të nenit 43 dhe në funksion, gjithashtu, edhe të disa konstatimeve që kanë bërë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, por, në radhë të parë, sepse e kemi si detyrim nga Kodi Zgjedhor, në një format të paktën në planin afatgjatë ankimin në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ky ankim duhet të jetë në Dhomë Këshillimi, por me procedura të përshpejtuara, që do të thotë afatet e ankimit, të paraqitjes së rekursit, paraqitja e kundërekursit nga subjektet zgjedhore, afatet e shqyrtimit të çështjes dhe të publikimit të vendimit gjithashtu duhet të jenë më të shpejta nga ana e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Lartë. Si Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kanë afate të mirpërcaktuara se kur duhet të marrin vendimet e tyre. Pra, duhet të bëjnë marrjen e vendimit jo më vonë se 3 ditë dhe afat shumë të shkurtër kohor, ku ata duhet të shpallin vendimin publik. Vendimi publik në bazë të rekomandimeve, për shembull ai i vitit 2019 në rastin konkret duhet të bëhet menjëherë publik në *website*-t përkatëse të gjykatës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne besojmë që ankimi në Gjykatën e Lartë do të jetë për shkaqe për të cilat gjykon të vlerësohen sipas ligjit përkatës të organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës Administrative. Vlerësojmë se nuk duhet të jenë për çdo gjë, por për shkelje të rënda procedurale, për zbatimin e gabuar të ligjit material dhe për të cilat sot Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vihet në lëvizje.

Damian Gjijknuri - Zoti Gumi, përse u fut përsëri Gjykata e Lartë kur dikur ka pasur një diskutim dhe reforma zgjedhore, sidomos ajo e vitit 2003, ku hoqi përfundimisht Gjykatën Kushtetuese në këtë rast ishte shkalla më e lartë e gjykimeve edhe e atyre zgjedhore? Përse rifutet përsëri një shkallë tjetër mbi Kolegjin Zgjedhor? Kjo për të sqaruar edhe anëtarët e komisionit, sepse mund të kemi edhe debat, aq më tepër që është një risi shumë e rëndësishme.

Viktor Gumi - Ky është një konstatim që ne bëjmë mbi bazën e leximit aktual të tekstit të Kushtetutës. Neni 43 i Kushtetutës së Shqipërisë thotë: “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile, për çështje administrative me rëndësi ose vlerë të vogël në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.

Ky është një nen, i cili është ndryshuar me reformën më të fundit kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, sepse edhe në vetvete të ligji “Për Gjykatën Administrative” ne kemi thënë se ka disa vlera, të cilat nga shkalla e parë nuk shkonin dot në shkallën e dytë. Ndërkohë ekziston edhe një parim i përgjithshëm kushtetues që kushdo ka të drejtë të ankohet ndaj një vendimi gjyqësor në një gjykatë të një niveli më të lartë. Kjo do të thotë që në kuptimin strikt, kur lexon tekstin e Kushtetutës ndaj një vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit për sa kohë e kemi konstatuar si gjykatë të shkallës së nivelit të parë, duhet të ushtrohet e drejta e ankimit, sepse nuk kemi të bëjmë me një çështje administrative të vogël, të një rëndësie të vogël, por është betejë për zgjedhjet dhe është e domosdoshme kjo gjë.

Damian Gjijnuri - Më sqaroni një gjë, që të jem unë i qartë, besoj edhe në emër të të tjerëve, kjo vjen si rezultat edhe i qartësimeve që janë bërë me ndryshimet kushtetuese që kemi tashmë në fuqi: a ka ndonjë rekomandim specifik apo ndonjë kritikë në lidhje me çështjen e mungesës së ankimit të vendimeve gjyqësore?

Viktor Gumi - Në dijeninë tonë, sepse do t’ju paraqesim me shkrim me referencë konkrete ligjore, ka pasur konstatime jo në kuadër të rekomandimit të mirëfilltë në pjesën përfundimtare, por ka pasur konstatime të pjesa arsyetuese e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it për shqyrtimin e marrëdhënieve gjyqësore nga kolegji, shkojnë deri në nivelin e Gjykatës Kushtetuese. Në mos gaboj është rekomandimi për zgjedhjet në vitin 2011, por me referencë konkrete, në pjesë konstatuese të saj e shikojmë të rekomandimet e OSBE/ODIHR-it.

Nga ana tjetër duke qenë ekspertë dhe duke parë këtë përputhshmëri ne jemi të detyruar të shikojmë si për çdo aspekt tjetër edhe përputhshmërinë e këtij drafti me përcaktimin kushtetues, pavarësisht se në vetvete mundet që kjo pjesë të jetë diku e fshehur, diku e thënë drejtpërdrejtë në rekomandime.

Pyetja që do të lindë dhe ne kemi parashikuar një dispozitë transitorë se çfarë do të ndodhë me situatën aktuale kur ne nuk kemi Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që sot në dijeninë time janë 4 gjyqtarë të Kolegjit Zgjedhor të cilët nuk kanë

kaluar procesin e vetingut. Pra, kemi problem edhe Kolegjin Zgjedhor, përpos teknologjisë që kemi pasur në atë pikë me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, zëvendëskryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pra edhe elementeve formale.

Kemi menduar që si një dispozitë tranzitore ne të ruajmë *status quo*-në aktuale. Kjo do të jetë e vlefshme deri në 5 vjet pas përfundimit të punës së KPK-së, që i bie diku në korrik të vitit 2022 gjykohet se do të jetë e vlerësueshme kjo gjë. Pra, më 1 shtator të vitit 2022 të hyjë në fuqi ankimi zgjedhor në Gjykatën Administrative të Apelit. Për zgjedhjet që do të zhvillohen deri më 1 shtator të vitit 2022 ankimi të mbahet përsëri në Kolegjin Zgjedhor. Për Kolegjin Zgjedhor për hir të natyrës transitore kemi parashikuar rregulla procedurale, të cilat janë aktualisht në Kod, por i kemi parashikuar si aneks. Janë hequr mbrojtjet që ekzistonin ndaj Kolegjit Zgjedhor, masat disiplinore e kështu me radhë, sepse fakti po tregon që ata po shkarkohen në kuptimin që nuk gëzojnë mbrojtje për shkak të pozicionit si Kolegj Zgjedhor. Duke qenë se gjykatat e apelit po rrudhen në anëtarësinë e tyre, jemi të detyruar që për sa kohë zgjidhen anëtarët e kolegjit të kemi të paktën, mundësinë të zgjedhim një në dy. Çfarë kuptimi ka? Hidhet shorti për 7 anëtarët kur kemi 7 kandidatë. Kemi menduar që të zgjerojmë *pull-in* duke pasur parasysh që do të krijohet një mjedis me numër më të madh, së pari në gjykatat e apelit në të gjithë territorin e Shqipërisë. Së dyti me Gjykatën Administrative të Apelit. Së treti me gjykatat administrative të shkallës së parë. Këtu vendoset sanksioni që brenda 45 ditëve për të gjithë këta anëtarë, gjyqtarë që ushtrojnë në këto detyra duhet të hidhet shorti nga kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor për këtë pikë dhe të citohet betimi, se për sa kohë qëndrojnë si një gjykatë e posaçme, ata duhet të bëjnë betimin. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka nevojë për betim, sepse e ka bërë në momentin që ka filluar detyrën, por për sa kohë janë si të posaçëm ata duhet të kenë një formulë betimi në këtë rast. Ky është si parashikim që kemi bërë me afat kohor, me rregulla procedurale, të cilat nuk janë gjë tjetër...

(Ndërhyrja pa mikrofon)

Kështu siç është. Ne kemi mbajtur formatin aktual, rregullat procedurale, tekstin e betimit e kështu me radhë. Pra, e kemi mbajtur siç ekziston në kolegjin aktual, duke qenë natyrë transitore nuk e ngarkojmë shumë, por e kemi parashikuar thjesht si aneks me qëllim që edhe nesër ai të jetë lehtësisht i shfuqizueshëm, pa u interferuar nga pjesa tjetër e neneve, sepse nuk mund të ketë bllok nenesesh të posaçme për këtë gjë.

Në dispozitat transitore ne i kthehemi përsëri atij debati që është zhvilluar këtu në fillim fare, sepse është lënë si detyrë e komisionit, por ne e kemi lënë si pjesë bosh, sepse nuk mund të draftojmë atë pikë për KQZ-në e parë që duhet të ngrihet sipas përcaktimeve të

këtij kodi, që ka një natyrë të veçantë dhe sipas diskutimeve që bëte herën e parë do ta shikojmë me një natyrë të dispozitës transitore për këtë pikë.

Teksti është voluminoz pothuajse vetëm 4-5 nene kanë mbetur pa prekur.

Damian Gjikhuri - Përpara se t'ua jap fjalën anëtarëve për pyetje, me sa kuptoj edhe për të sqaruar ata që na dëgjojnë qëllimi ka qenë që të gjitha këto dispozita të përshtaten me ndryshimet të cilat ne i kemi paraqitur edhe më parë në këtë komision, pavarësisht se nuk i kemi miratuar, por që krijojnë një harmoni të plotë me parimin e thjeshtimit. Është e vërtetë ajo që keni konstatuar që Kodi ka qenë më shumë si një manual apo udhëzim i detajuar, por Kodi duhet të jetë një tekst parimesh dhe shumë brumë, i cili ka të bëjë me procedura të veçanta apo detaje. Gjatë zbatimit duhet të mbushet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me akte normative. Shumë mirë që e keni parashikuar! Më pëlqen kjo, sepse Kodi ishte bërë aq i detajuar sa ndonjëherë dilte ndonjë paqartësi gjatë praktikës dhe e kishin të pamundur edhe KQZ-ja të bënte një ndërhyrje, kur ndërkohë ndërhyrja ka pasur edhe dakordësi politike, kishte kuptim dhe e kishte të pamundur. Pra, kjo është shumë e rëndësishme, sepse mund të ketë nga njerëz të caktuar objeksione siç ishte dyshimi i parë: pse është bërë kaq pak e detajuar kësaj radhe? Unë them se kjo është një risi pozitive. E rëndësishme është që të vendosim parimet, pasi ka një praktikë tashmë të konsoliduar. Besoj se nuk është më debati sesi zhvillohen procedurat e votimit, sesi merret fleta e votimit, si paloset ajo. Këto janë gjëra që praktika tashmë i ka thjeshtuar.

Për sa u përket sugjerimeve tuaja, besoj se edhe ato kanë nevojë për një diskutim. Ajo që mund të marrë më tepër debat është futja edhe një herë e një shkalle të lartë të ankimit gjyqësor, pra që është Gjykata e Lartë. Kjo ka anët e saj pozitive, sepse kemi të bëjmë me një shqyrtim më të thelluar nga dy nivele, që do të thotë se edhe parimi i drejtësisë kur shikohet nga dy nivele plotësohet. Kemi një shikim profesional, por kemi edhe anën tjetër, që do të zgjasë pak në kohë. Ndonjëherë në situata zgjedhore këto krijojnë tensione dhe shpeshherë gjykatat vihen përpara presioneve të tilla politike.

Ndoshta do të ishte vendi, kjo është gjë për t'u diskutuar nga ne, mendimi im që të mund të lihet ankimi në Gjykatën e Lartë vetëm për aktet të karakterit normativ ose mund të shikohet për çështjet që kanë të bëjnë me rezultatin zgjedhor për të evituar çdolloj ankimi të karakterit tjetër, që besoj se është e mjaftueshme. E dyta, mund të shikohet që pas ankimeve të karakterit zgjedhor nëse do të mbajmë dy shkallë, le t'i hiqen KQZ-së, por kjo mund të sjellë edhe disavantazhin tjetër që hetimi administrativ është më i thjeshtë nga pikëpamja e administrimit të provave, këqyrja e materialeve dhe ky është një problem. Pra, duhet të shikohet edhe kjo pjesë.

Me sa kuptova ankimi në Gjykatën e Lartë, shtimi i një shkallë gjyqësore është për periudhën pasi të ketë mbaruar procesi i vetingut, pas vitit 2022. Pra, është bërë mirë kështu, sepse procesi i vetingut mund të sjellë edhe probleme me formimin e Gjykatës së Lartë. Ne nuk duam që zgjedhjet, një proces kaq jetik të mbahen peng për shkak të një boshllëku institucional.

Jam dakord. Kolegët kanë pyetje në lidhje me ato që u paraqitën këtu? Po, zoti Alimadhi. Një anëtar nga e majta dhe një nga e djathta siç e kemi bërë gjithmonë.

Adriatik Alimadhi – Zoti Gumi, te neni 102 “Veprimtaria e administratës zgjedhore”, paragrafi 4 ku bëhet numërimi manual i votave, nga eksperiencia ime, si dhe nga vëzhguesit që kishim pranë grupeve të numërimit dhe pranë KZAZ-ve zakonisht kur vëzhguesit tanë bënin numërimin e votave, gjatë numërimit dilnin më shumë vota, gjatë numërimit manual në momentin e fundit, pra kur i numëronin votat, dilnin më pak dhe mbushej procesverbali. Para se të mbushet procesverbali, a ka mundësi që ne të vendosim që një nga vëzhguesit e subjekteve që paraqet një ankesë të tillë të rinumërohet përsëri, sepse sa herë që kemi paraqitur ankesa në këtë moment të gjitha janë hedhur poshtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbaron një qendër votimi, vëzhguesi deri në këto momente i ka numëruar, pastaj kur bëhet mbushja e procesverbalit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vëzhguesi ka mbajtur votat e subjektit. Por çfarë bëjnë grupet e numërimit? E mbushin dhe ia japin një subjekti tjetër politik. Vëzhguesi i subjektit tim në rastin konkret i ka votat e numëruara vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, ky do të bëjë një ankesë. Ne kemi bërë ankesa dhe nga trupa atje nuk është marrë në konsideratë, e kanë mbyllur këtë kapitull duke thënë: “Kaq vota kishte!”, duke e shpërfillur fare si rast. A ka mundësi ta shikojmë nëse ka ndonjë ankesë nga vëzhguesit e subjekteve politike?

Ilir Rusmali - Faleminderit!

Ndoshta duhet të thuhet që në fillim që kemi të bëjmë me një praktikë të së shkuarës, praktikë të strukturave politike të administrimit të zgjedhjeve. Në rastin konkret, pa dashur të akuzoj askënd kazusi lë të nënkuptohet për një ankesë ndaj një strukture që manipulon rezultatin e zgjedhjeve dhe pastaj ka të drejtë të vendosë ta rrëzojë ankesën, sepse është manipulatori dhe nuk mund të dekonspirojë vetveten. Por ky është mekanizmi që ka qenë, mekanizmi që krijohet është tjetër. Ai është apolitik dhe profesional.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Do të thotë se sistemi nuk lejon refuzimin e kërkesave dhe nuk lejon bllokimin e transparencës së ankesave nga fillimi deri në fund. Prandaj ne e kemi çuar hap pas hapi deri te numërimi *a posteriori* i të gjitha kutive të votimit. Nëse del rezultati dhe hartohet tabela e qendrës së votimit, tabela është publike, çdo subjekt merr automatikisht kopjen e tabelës dhe tabela është e ankimueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjijnuri - Po jua jap unë përgjigjen. Nuk është çështje ekspertize. Ja duro, po e them unë. E para tha, kjo situatë e supozuar që unë nuk e di sa e vërtetë është, zhduken 700 vota, sepse kur janë hapur kutitë edhe në Shkodër, edhe në Lezhë, edhe në Tiranë, ka pasur devijime maksimumi 1 votë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alimadhi, të lutem!

Në çdo palë zgjedhje ka akuza të tilla. Çfarë ka treguar praktika dhe jo gojëdhëna? U hapën kutitë në Tiranë dhe në të gjithë qarkun e Shkodrës (e mbaj mend ka qenë kandidati juaj që pretendonte, një nga ata në vitin 2013)...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mirë një i opozitës apo i maxhorancës. Çfarë rëndësie ka?

U hapën në qarkun e Lezhës. Çfarë nxori rezultati, rinumërimi? U hapën kuti më kuti, rinumërimi zgjati dy javë, që nuk ka bërë ndonjëherë vaki në Shqipëri. Edhe në Tiranë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta mbaroj!

Çfarë nxori rezultati? Devijimi më i madh ishte 1-2 vota, që mund të jetë gabim teknik. Jo 700 vota...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe unë kam bërë shumë zgjedhje dhe e di shumë mirë atë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

200-300, çfarë rëndësie ka?

Një minutë, si e ka Kodi?

E para, ai tha një element të rëndësishëm: kemi të bëjmë me njerëz që nuk e kanë incentivën për të vjedhur. Pse po e bëjmë depolitizimin?!

Ti thua: “Unë bëj sistem depolitizimi dhe po i vë një roje tjetër sipër tani”. Roja je ti aty. Një njeri që zgjidhet në mënyrë jopolitike nuk e ka incentivën të shkelë ligjin në atë

mënyrë. Le të themi, që u çmend ai, ndodhi. E para, ke mundësinë e votave të kontestuara, ku vetë komisioneri i zonës së administrimit apo njësia e administrimit zgjedhor shkon dhe rivlerëson votën.

E dyta, ai të tha një gjë të rëndësishme: transparenca pas zgjedhore, do të thotë që ti ke të drejtë t'i thuash: “E hape kutinë”, ai shkon në burg.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e do ti? Çfarë propozimi ke? Merr të gjithë filmimin e fletëve të votimit.

Adriatik Alimadhi - I kemi çuar edhe në prokurori...

Damian Gjiknuri – Një minutë!

Ke procesin e ankimit. Ky është tipik rasti që hapet kutia e votimit. Nuk ka shans, që kanë dalë fletët atje. Duket qartë që subjekti “Balli Kombëtar” ka pasur 50 vota....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj është ankimi që mban një balancë me stabilitetin e menaxhimit pa e mbajtur atë peng.

Nga ana tjetër u krijon mundësi, akses palëve për të kundërshtuar aty ku kanë të drejtë. Është zgjedhur shumë mirë: transparenca postzgjedhore dhe procesi i ankimit. Ndoshta ka ndonjë zgjidhje tjetër nga ekspertët.

Ilir Rusmali – Ne mund të mendojmë edhe zgjidhje shtesë. Realiteti shqiptar është ai që është. Kjo përpjekje është për t'iu kundërvënë realitetit shqiptar. Për këtë punë po bëhet. Pra, nuk mund të themi që nuk ka lëvizje në këtë drejtim. Po bëhet kjo lloj përpjekje me qëllim që tentativat të mos kenë më hapësirë. Ne mund të mendojmë edhe mekanizma shtesë për të forcuar këtë gjë, por edhe mund ta forcojmë edhe shumë më tepër sesa kaq, por duhet të kuptojmë një gjë: është një gjë kërkesa qëllimshme e zotit Alimadhi dhe një gjë tjetër është instrumenti që jepet për abuzim. Ne duhet t'i shikojmë të dyja elementet bashkë. Nëse i japim një instrument për abuzim, ky i fundit dëmton edhe zotin Alimadhi, edhe procesin bashkë. Pra, ndoshta është mirë ta mendojmë se çfarë kemi në dispozicion sot, na ndihmon të mos ketë manipulim të numërimit apo jo? Nëse themi nuk mjafton, mund të bëjmë edhe më shumë sesa aq, por rreziku, duhet të jemi të vetëdijshëm do të jetë që do t'i japim një instrument abuzimi vëzhguesit që mund ta përdorë masivisht kur të dojë këtë gjë. Nëse jeni te qetë me rrezikun e abuzimit nga vëzhguesit, ne nuk kemi asnjë problem. Ne e kemi edhe të identifikuar se ku mund të ndërhyjmë, për aq sa i takon ligjit, sepse kjo procedurë masivisht rregullohet nga aktet nënligjore.

(Ndërprerje incizimi)

Adriatik Alimadhi -...që në Shqipëri është vjedhur vota. Po ju kujtoj vitin 2005. Më kanë lënë 24 mijë vota. I kanë marrë të gjitha votat e mia me procesverbal, KZAZ-të ia kanë dhënë Partisë Republikane, e cila mori 11 mandate.

Ju lutem më kuptoni!

Nuk dua asgjë, por nga momenti që përfundon së numëruari një qendër votimi vëzhguesi është prezent, por ky kryen një veprim. Nga momenti që ky kryen një veprim, a nuk ka të drejtën në fund kur nuk i rakordojnë votat midis atyre që bëhet numërimi manual me ato që ai i ka parë vetë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shyqyr!

Faleminderit!

Kam edhe diçka, kur bëhet numërimi manual i votave gjatë procesit në qendrat e numërimit zyrtarët zgjedhorë të pranishëm në të gjitha njësitë janë në ushtrimin e detyrave, kandidatët, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, a mos duhet këtu të jenë të gjitha subjektet pjesëmarrëse, se janë 100 e ca apo 66 parti dhe ndoshta do diçka më specifike, më të përcaktuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, shikojeni si mundësi.

Damian Gjijnuri - Ka të drejtën të jetë vëzhgues, nuk kemi çfarë t'i bëjmë. Qëllimi është të reduktojmë garuesit në garë, gjë që ndoshta do ta sjellë koha, siç e tha zoti Murrizi.

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni - Nëse vlen si eksperiencë për këtë diskutim, unë kam marrë pjesë si numërues në dy zgjedhje franceze. Mua më ka habitur thjeshtësia dhe saktësia e sistemit francez. Dy persona në mënyrë publike numërojnë votat dhe ia tregojnë vëzhguesve qofshin partiakë apo të paanshëm, të cilët qëndrojnë rreth e rrotull tavolinës, pa shirita dhe dy persona të tjerë në mënyrë paralele, të paanshme numërojnë. Nëse të dy numrat e dy numëruesve në përfundim të numërimit të votave përputhen me njëri tjetrin, ky është përfundimi i numërimit. Kryetari i komisionit të numërimit apo të administrimit të votave firmos procesverbalin dhe çdo gjë mbaron. Nëse 1, 2 ose 3 vëzhgues ngrenë shqetësime lidhur me mënyrën e numërimit, pra ka probleme me numërimin e votave e të tjera është në tagrin e administratës zgjedhore që të vendose nëse do të rinumërohen apo jo. Unë thjesht po sjell sistemin francez, tek i cili kam besim. Nëse administrata zgjedhore në atë moment, ata që janë zyrtarë të administratës vendosin që të dy numëruesit përputhen, numërimi është në rregull dhe ankesat, shqetësimet e shprehura nga vëzhguesit partiakë janë të pavlefshme

ata mbyllin procesverbalin. Pastaj ka procedura të tjera për ankimim. Unë mendoj se mund të shikojmë mundësinë e hapësirës së dëgjimit të shqetësimeve të vëzhguesve, por nuk mund t'u japim vëzhguesve tagrin e plotë. Imagjinoni, janë 10 vëzhgues, secili ka ankesa. Do të vonohet numërimi, një tmerr i vërtetë apo jo? Nuk e di se çfarë mendimi kanë ekspertët për këtë gjë.

Ilir Rusmali - Rreziku është evident që është instrument abuzimi. Nuk themi që do të ndodhë, se nuk mund ta themi këtë gjë, ne nuk parashikojmë që vëzhguesit, apo vëzhgues të caktuar do të jenë të tillë, në keqbesim ndaj procesit, por nëse themi i takon çdo vëzhguesi, rreziku është që një numër i caktuar vëzhguesish bllokojnë procesin vetëm me këto lloj ankesash.

Nëse ne e vendosim të gjithën në kontekstin e këtij procesi reforme, gjëja në vetvete relativizohet. Ne po diskutojmë si mekanizëm vlerësimi dhe numërim mekanizmin elektronik, i cili është ende në tavolinë, nuk ka ikur. Ai e asgjëson automatikisht procesin, nëse e ardhmja e Shqipërisë do të jetë votimi dhe numërimi elektronik. Votimi dhe numërimi manual do të jetë dispozitë parazite e këtij ligji. Është këtu, sepse i kemi ende të dyja opsionet e hapura. Është këtu, sepse gjithmonë votimi elektronik ose numërimi elektronik do ta ketë rezervë veprimin manual. Ai do të jetë gjithmonë rezervë. Nëse rezervën duam ta rrisim deri në këtë detaj, atëherë ne e kemi mundësinë që ta bëjmë.

Damian Gjijnuri – Mendoj që në njëfarë mënyre padashje ndërhyrjet e Zotit Alimadhi dhe zotit Gjoni nxjerrin në pah edhe atë kontradiktën që të gjithë ligjvënësit kanë për të administruar proceset me shumë aktorë. Është debat interesant me thënë të drejtën, sepse nga njëra anë me të drejtë zoti Alimadhi tha: “Vëzhguesit, e drejta”, si ka mundësi ai që në çast të ripërtërijë procesin dhe të ketë mundësi të korrigjojë shkeljen e pretenduar në moment dhe nga ana tjetër mundësia e destabilizimit të procesit, parimi i transparencës, kundër parimit të destabilizimit apo mungesë së qëndrueshmërisë.

Ajo që thatë ju, Franca nuk është larg nga Shqipëria pavarësisht se ata e kanë në qendër votimi, pra në themel. Vëzhguesi pretendon. Në momentin që ngrihet dora nga vëzhguesi ka gjithmonë një rinumërim nga grupi i numërimit. Kur ka një pretendim përpara mbylljes së rezultatit është komisioni zonal zgjedhor, që besoj se të njëjtat parime duhet të qëndrojnë, marrin vendim dhe sigurojnë se pretendimi i ngritur të adresohet në atë moment. Nga ana tjetër, është procesi ankimor, i cili është më i gjatë.

Megjithatë, le t'i martojmë të dyja shqetësimet bashkë, nëse ka ndonjë element shtesë, ta vrasim mendjen, shikojeni këtë, që të mund të garantohet edhe pretendimi i çastit, kuptohet pa vënë në dyshim vazhdimësinë dhe sigurinë e procesit.

Faleminderit!

Pyetje tjetër? Zonja Gjylameti, kishit ndonjë ndërhyrje?

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Gjijknuri!

Edhe pse isha e para që kërkova fjalën, ma dhatë të tretës. Megjithatë, gjithmonë duke respektuar opozitën, prita me durim.

Pyetja ime ka të bëjë me nenin 99, me rastin kur një nga palët e interesuara, pra forcë politike, kërkon të rinumërohet, pra të rishikohet rezultati.

Te neni 99, në pikën 4, keni përcaktuar: Këqyrja bëhet me kërkesën e palëve të interesuara. Ato mbulojnë shpenzimet e të gjitha pikat përkatëse.

Thuhet: “Në rast se një palë e interesuar kërkon këqyrjen e fletëve të votimit ose të materialit zgjedhor, që është këqyrur më parë, kërkesa i refuzohet dhe i vihet në dispozicion videoja e...” ”

Pyetja ime lidhet edhe me çfarë thanë më përpara kolegët e opozitës. Për sa kohë, që në krye të herës ka një lloj mosbesimi ndaj procesit, pra vëzhguesi e ka parë, ka bërë ankimin, ndërkohë, është ankim për një prej kutive, që për shkak të detyrës funksionale të KQZ-së që kontrollon, mund të jetë këqyrur më parë, por të një pale tjetër, si do të arrijmë ne t’i krijojmë besimin që ai rezultat është vullneti i shprehur nga votuesit, dhe se nuk është cenuar, për sa kohë, ekzaktësisht, kalojmë te kjo pikë që kanë mosbesim ndaj procesit?

Përse keni menduar, dhe cili është qëllimi, që do të jepni videon dhe jo të rinumërohet në prezencë të përfaqësuesve të partive politike?

Në anën tjetër, unë mendoj se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të vazhdoj, të lutem? Në fund pastaj, mund të vazhdojmë edhe me pjesën tjetër.

Pika tjetër ka të bëjë me një gjë, e cila sipas meje është risi dhe ndihmon në të gjitha proceset...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...dhe krijon një memorie historike, ajo që saktësisht mungon në KQZ. Sepse, ne kemi pjesën e tabelave, ne kemi rezultatet ndër vite, por memoria historike e të gjitha proceseve zgjedhore, është memorie historike e vetë partive, por në institucion nuk ekziston.

Në lidhje me këtë pjesë, unë mendoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Alimadhi, mos ndërhyjni!

Për mendimin tim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shiko, unë jam nga ata njerëz që e ruajnë qetësinë, pavarësisht bërthmës së kolegëve, sepse ngritja e zërit nuk është argument. Sado që ta ngrini zërin, unë jam shumë e qetë si natyrë. Kësisoj, do të lutesha, sepse ajo pjesa nëse e kuptoj unë apo jo, si dhe fyerjet tuaja, më bëjnë të jem më e qetë përballë jush.

Pra, gjëja që unë e mendoj si risi, është pikërisht krijimi i një memorieje historike. Ajo çfarë partitë ngrenë dhe pretendojnë gjithmonë, është ajo çfarë ndodhet në memoriet e tyre, ndërkohë që memoria e institucionit ka munguar gjithmonë.

Nëse sot do t'i drejtohesh KQZ-së me një shkresë, se çfarë ka ndodhur në vitin 2005, çfarë ka ndodhur në 2009-ën, mund të ketë një dokument, por që ta shikojmë me pamje... Sepse, besoj se më 2011 kemi filluar për herë të parë, apo në 2009-ën, me regjistrimin e tavolinave të numërimit. Në 2011-ën, besoj. Më përpara nuk e kemi pasur këtë.

Nëse do t'i riktheheshim, do të kishim mungesë. Në lidhje me këtë pjesë, mendoj se është risi krijimi i memories institucionale nëpërmjet videoregjistrimit, por nga ana tjetër na ndihmon në gjithë ato procese që mund të kenë palët e cenuara, të cilat ankimojnë.

Nga ana tjetër, te pika 8 thuhet se rezultatet e verifikimit paszgjedhor nuk mund të jenë bazë në vetvete, por as nuk mund të shërbejnë, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë për ankimimin, kundërshtimin, mosnjohjen e rezultatit apo ndërprerjen e mandatit, prej cilitdo subjekt, person i interesuar apo institucion që kërkon të ndërmarrë hapa ligjorë në këtë drejtim.

Te një pikë e mëparshme, ju thoni se KQZ ka detyrimin të referojë në institucionet e drejtësisë në lidhje me çfarëdo shkeljeje, përkundërt gjithë administratës zgjedhore, që mund të jetë angazhuar në procese të shkeljeve të dispozitave përkatëse, ndërsa në anën tjetër thuhet se rezultatet e verifikimit paszgjedhor nuk mund të shërbejnë.

Unë do të doja pak më shumë sqarim, për të ditur se cili ka qenë qëllimi i një formulimi të tillë, si dhe cila është arsyeja që nuk shërben.

Domethënë, dua ta nis tek e para, e dyta, e më pas tek e treta.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Para se zoti Rusmajli të fillojë me përgjigjet, ju lutem, anëtarë të komisionit, që të mos ndërhyjnë ndërkohë që deputetët flasin. Nëse keni diçka për të thënë, mund ta mbani shënim, që pastaj të shpreheni. Ne do t'ia mundësojmë secilit prej jush të drejtën e fjalës.

Faleminderit!

Ilir Rusmajli – Faleminderit për pyetjen!

Ndoshta ka vend të sqarohet kjo dispozitë, sepse është dispozitë e re, që shpresojmë dhe besojmë shumë se do të japë efekt. Kjo nuk është një dispozitë, një e drejtë, një mundësi, një prerogativë e subjekteve elektorale për të mbrojtur interesat e tyre të cenuara nga procesi. Interesat e tyre të cenuara nga procesi, subjektet elektorale i mbrojnë nëpërmjet të gjitha dispozitave që kanë në raport me ankimimin, me gjithë procedurën që zhvillohet.

Kjo është një gjë që ndodh pas zgjedhjeve, pasi ka përfunduar gjithçka, dhe nuk ka lidhje as me videoregjistrimin e grupeve të numërimit. Ai është proces më vete.

Kjo është një dispozitë, e cila vihet aty për të mbrojtur sistemin, gjithë sistemin, nga tentativat për manipulim, si pasojë për të ringritur besimin tek sistemi.

Në qoftë se pas zgjedhjeve, bëhen në mënyrë të përsëritur verifikime të tilla, dhe nga verifikimet del se rezultatet janë të mira, do të thotë se jemi në rrugë të mbarë, kështu që edhe njerëzit rrisin besimin. Nëse del se ka pasur manipulime, do të thotë se duhet të përpiqemi të korrigjojmë gjënë, dhe eventualisht shteti duhet të ngrihet në këmbë kundër manipulimit.

Prandaj vjen edhe paragrafi 8, që thotë se drejtat e subjekteve të cenuara nuk mbrohen nga kjo dispozitë, por nga dispozita të tjera, të cilat kanë lidhje me ankimin.

Kjo i shërben shtetit për të kontrolluar dhe korrigjuar sistemin. Kjo nuk pengon hetimin penal. Përkundrazi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Zoti Alimadhi, të lutem mbaj qetësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Rusmajli – Sistemet juridike kështu ngrihen në këmbë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky ligj do të kishte problem në qoftë se do të mohonte të drejtën e ankimimit dhe do të cenonim një standard shqiptar. Në qoftë se subjektit i jepet e drejta e ankimimit, në qoftë se subjektit i jepet e drejta e vëzhgimit, në qoftë se subjektit i jepet e drejta e kontestimit, por subjekti nuk i shfrytëzon këto, ai ka humbur të drejtën e pretendimit.

Kështu është rregulli. Kështu ngrihen në këmbë sistemet. Në qoftë se nuk ngre padi në afatin e padisë, nuk ke të drejtë të flasësh më.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu ngrihen sistemet në këmbë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Të lutem, respekto rregullin! Ka shumë gjëra që janë të padrejta, por të drejtën mund ta kërkosht nëpërmjet një sistemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Iir Rusmajli – Ka shumë rëndësi të kuptojmë se përse duhet, dhe ka shumë rëndësi të mbrohemi nga rreziku që sjell. Nuk vendosim një dispozitë, e cila...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë: ne nuk duam të vendosim një dispozitë, e cila destabilizon pushtetin e zgjedhur, kushdoqoftë ai.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne duam të vendosim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qëllimi i kësaj dispozite...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po më duhet t’i përgjigjem zonjës Gjylameti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duhet t’i përgjigjem zonjës Gjylameti. Duhet t’i jap përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë prandaj e shpjegova që në fillim qëllimin e dispozitës. Qëllimi i dispozitës nuk është të mbrojë interesat e palëve në proces, sepse interesat e palëve në proces mbulohen nga kapituj të tjerë. Nuk mund ta analizojmë dispozitën kundër qëllimit të vet. Nuk është për këtë punë. Për mbrojtjen e interesave të palëve janë ca të tjera. Kjo është për mbrojtjen e sistemit nga abuzimi, për korrigjimin e sistemit, nëse ka abuzim.

Ne mund të biem dakord ta kontestojmë akuzën për manipulime zgjedhjesh. Ajo që është e vërtetë se ka ndodhur rregullisht në Shqipëri, është se kurrë nuk është verifikuar mbrapa kjo gjë, për hir të sistemit. Ne sugjerojmë se një mekanizëm i tillë i shërben mbrojtjes së sistemit.

Në qoftë se administratorët zgjedhorë do ta dinë se më pas, kur të mbyllet procesi, puna e tyre do të kontrollohet, do të jenë të kujdesshëm që të bëjnë punën me saktësi dhe siç duhet. Prandaj ka rëndësi ky lloj mekanizmi, sepse e mbron të pastër sistemin. Nuk ka rëndësi në raport me të drejtat e cenuara të palëve. të drejtat e cenuara të palëve mbrohen me mekanizma të tjerë. Transparenca e kësaj dispozite është e rëndësishme për gjënë tjetër.

Ka shumë rëndësi të kuptohet se kjo dispozitë nuk mund të përdoret në asnjë lloj rrethane për të destabilizuar pushtetin e zgjedhur, sepse në një vend nuk mund të ketë ligj, i cili të ketë si objektiv destabilizimin e sistemit, pushtetin e zgjedhur, t’i heqë legjitimitetin atij. Në asnjë vend të botës.

Prandaj, në qoftë se kjo dispozitë pranohet me këtë logjikë, është mirë të jetë. Në qoftë se ka dyshime rreth logjikës së dispozitës, është më mirë ta hiqni, se sa ta mbani për interesat e palëve në proces.

Damian Gjikhuri – Mbase më takon të bëj një koment të përgjithshëm, sepse them se duhet të shikojmë edhe përtej shqetësimeve të ngritura këtu. Mendoj se kjo është dispozitë jashtëzakonisht e guximshme, e cila në mënyrë të natyrshme do të sjellë një vetëfrenim të çdo lloj egoje politike, qoftë edhe rastësore në administratë, për të futur duart në zgjedhje. Pse? Sepse fakti se do të kontrollohen gjithmonë, do t'i bëjë të gjithë zyrtarët dhjetë herë më të përgjegjshëm.

Në mënyrë indirekte, kjo adreson edhe shqetësimin që mund të ngrenë subjektet politike në lidhje me administratën. Pra, ajo që tha eksperti, se vërtet ke të drejtën e ankimit në lidhje me procesin e administrimit dhe numërimit të votave, pra ke një mënyrë për të korrigjuar sa i takon të drejtës së shkelur, por nga ana tjetër, forcimi i këtij sistemi, frika e administratës, garancia që kjo administratë do të jetë efiçente, e mbi të gjitha do të jetë me integritet për sa i përket administrimit të votimit, numërimit dhe rezultatit, do të bëjë të mundur që të adresohet edhe shqetësimi yt. Në fund të fundit, ky është edhe qëllimi i drejtësisë. Për çfarë i kemi ne institucionet, në përgjithësi? Jo çdo shkelje mund të parandalohet. Natyra njerëzore bën që të ketë shkelje në çdo fushë, ama garancia është se sa ndëshkohen këto shkelje, dhe a ka administratë të tillë, e cila të evidentojë provat për këto shkelje, në mënyrë që të identifikohen edhe zyrtarët përgjegjës. Nëse arrijmë këtë, kjo është idealja që ne kërkojmë në drejtësi: të gjejmë autorët dhe t'i ndëshkojmë. Nuk besoj se do të ketë vazhdimisht persona që janë të gatshëm të përballen me burgun dhe me dënimet e ashpra që e shoqërojnë atë, apo qoftë edhe me pengesat që ka një zyrtar zgjedhor që shkel ligjin. Nuk besoj se ka aq kandidatë dhe njerëz të gatshëm që vetësakrifikohen. Përkundrazi, në qoftë se ne do të kemi disa shembuj, e praktikisht Shqipërisë kjo i kërkohet, të ketë shembuj ndëshkimesh në raste abuzimesh, kur ato evidentohen, kjo do të ishte dëshmia më e mirë e bërjes së një administrate efiçente e të mirë zgjedhore.

Kësisoj, unë them se kjo është një dispozitë, e cila, edhe nga pikëpamja e pikëpyetjes që mund të ngrejë destabilizimi... se për shembull, dikur me këtë mbrohej një ish-Kryeministër, sepse është ai parimi: transparenca apo turpërimi, sepse njihen këto.

Në një proces zgjedhor vërtet që mund të mos kthehet rezultati, por do të ishte i manipulueshëm në atë shkallë, siç ka ndodhur në Shqipëri në zgjedhjet e vitit 1996 apo në zgjedhje të tjera, kur manipulimet kanë qenë në atë shkallë, sa i shndërronin zgjedhjet në

ilegjitime, normal që do të ketë zgjedhje të tjera, do të ketë edhe ndëshkime, dhe çdo qeveri do të mbajë përgjegjësi.

Unë besoj se është në të mirën e çdo qeverie, e atyre që kanë shumicën apo e atyre që kanë pushtet publik, që të bëjnë çmos për parandalimin e çdo lloj shkeljeje zgjedhore. Kjo dispozitë do t'i vërë edhe më shumë para përgjegjësisë ata që janë në pushtet, apo qoftë dhe ata që administrojnë proceset zgjedhore, që ta dinë se, nëse pasoja të tilla, të cilat njerëzit do t'i shikojnë një ditë, mund të rrezikohet edhe pushteti i tyre. Kësisoj, ajo që thotë Alimadhi nuk qëndron, sepse askush nuk e do pushtetin në mënyrë ilegjitime. Nuk është problemi të kapësh diçka, por a e ke legjitimitetin për të qeverisur, dhe legjitimiteti për të qeverisur vjen nga një proces i rregullt zgjedhor.

Unë thashë ato shembuj, por ka pasur shumë pretendime në Shqipëri, ka pasur pretendime masive, dhe më vjen keq që e përsërita atë. Sa herë janë hapur kutitë dhe janë numëruar dyqind-treqind kuti, ka rezultuar se devijimi i votave ka qenë një, ose maksimumi dy vota. Kjo do të thotë se nuk ka pasur prova të tilla, siç e thonë edhe raportet e ODIHR-it, që të kenë çuar në tjetërsim të rezultatit zgjedhor. Kjo është evidente në çdo palë zgjedhje.

Mirë. Pa e zgjatur, a ka ndonjë pyetje tjetër në lidhje me propozimet këtu?

Unë them t'i falënderojmë ekspertët. Natyrisht, këto janë projekte. Do të kërkoja nga ekspertët, që tashti të bëhet një përmbledhje e të gjithë propozimeve, duke i shoqëruar anash, në përputhje me rekomandimet, pasi unë dhe bashkëkryetarja do të nisim një proces për marrjen e një opinionit paraprak.

Kuptohet, ne nuk po i hedhim në votim këto, pasi do të vazhdojmë edhe me çështjen e sistemit zgjedhor, për të cilin kemi rënë dakord ta trajtojmë në janar, në një mbledhje të posaçme, duke ftuar të gjithë aktorët politikë.

Së fundi, doja të thosha se ka ardhur edhe një propozim nga ministri i Shtetit për Diasporën, ndërkohë që nga një grup pune nga ekzekutivi kanë ardhur disa propozime në lidhje me votën e emigrantëve, propozime të cilat dua t'ua jap ekspertëve dhe anëtarëve të komisionit, sekretaria le t'i administrojë, me qëllim që t'i trajtojmë ato, qoftë në fazën e dytë, që kemi vendosur, qoftë edhe sipas atyre parimeve, që ju tashmë keni vënë në kod, në ç'mënyrë mund të përfshihen dhe çfarë mund të bëjmë në lidhje me to.

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Unë dua të falënderoj ekspertët për punën e bërë, si dhe do të doja të insistoja të ishte në rekord në komision. Ky është një draft i pabazuar në asnjë model specifik, pra është një draft-propozim.

Mendoj se nuk duhet përpiluar një draft përmbledhës dhe të çohet për opinion, apo të hidhet për votim në komision, pa u bërë edhe një draft tjetër krahasues, i bazuar mbi një model tjetër, siç solla unë sot modelin rumun. Mund të jetë edhe ndonjë model tjetër, se përmenda Rumaninë ngaqë e kam studiuar si çështje.

Mendoj se nuk duhet marrë e mirëqenë që, thjesht pse kemi dëgjuar në tri seanca tre drafte të këtij propozimi, ky do të jetë drafti i komisionit. Pra, nuk dua të prezumohet që metodologjia e punës të merret e mirëqenë, që ky është drafti i propozuar dhe ne do të votojmë mbi këtë draft, që do t'i çohet ODIHR-it për ekspertizë apo për opinion e të tjera.

Unë mendoj se ne duhet të kemi edhe një draft tjetër, bazuar në një model tjetër, për të parë se si administrohen zgjedhjet në vende të tjera, ku kemi *positiv modus*, pastaj t'i marrim, t'i bashkojmë, të debatojmë. Vetëm atëherë mund t'ia çojmë ODIHR-it.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Edhe unë dua t'i falënderoj ekspertët në lidhje me draftin e paraqitur sot. Gjithashtu, dua të falënderoj anëtarët e komisionit, që ishin të pranishëm dhe bënë pyetjet e tyre në lidhje me këtë draft.

Në lidhje me kërkesën, zoti Gjoni, mendoj se, nëse ke dëshirë të ketë modele të tjera, që t'i ballafaqojmë apo t'i shohim më në detaje, më së pari duhet ta konsultojmë bashkë si anëtarë nëse do të ketë ndonjë model tjetër. Mund të jenë të shumtë modelet që do të shikojmë. Mua, për shembull, më pëlqen modeli i Letonisë për zgjedhjet. Ka mënyra të ndryshme që mund t'i shohim. Nëse ne si opozitë biem dakord në lidhje me një model, mund ta paraqesim. Ashtu siç erdhi kërkesa e ministrit të Diasporës, ashtu mund të bëjmë edhe ne një kërkesë. Gjithsesi, kjo nuk duhet ta ndalojë procesin e kësaj që po bëjmë.

Do të doja të dija nga ekspertët, nëse do të ketë një draft tjetër apo ky është drafti përfundimtar, sepse as kjo nuk është e qartë.

Ilir Rusmajli – Në gjithë materialin ë ju kemi dhënë juve, ne jemi përpjekur të bëjmë më të mirën tonë të mundshme. Më të mirën e mundshme. Në qoftë se na e vini si detyrë, që të përmirësojmë më të mirën tonë, ju garantojmë se nuk e bëjmë dot më të mirë se kaq.

Ne jemi gati të studiojmë të gjitha materialet alternative, edhe modelet alternative, edhe të punojmë mbi to, por ne duam të dimë paraprakisht, se çfarë kërkonit te modelet alternative. Sepse janë aq shumë, ka aq larmi, ka aq shumë realitete, sa që është e pamundur të marrësh një realitet të ri, ta përshtatësh, e pastaj të kënaqësh gjithë komisionin.

Ne kemi punuar mbi orientimin tuaj, mbi rekomandimet, mbi realitetin shqiptar, mbi njohurinë tonë në lidhje me realitetin shqiptar dhe teknikën legislative, dhe kemi prodhuar këtë material.

Ky material është ai që ne kemi konsideruar se mund të bëhej me iniciativë nga ne. Përtej kësaj, ne nuk punojmë dot me iniciativë, në sensin se po nuk pati vendimmarrje në lidhje me çështje që janë sensitive, politike, sistemi, ne nuk hedhim dot asgjë në letër, pa e ditur çfarë doni, sepse është vendimmarrje politike.

Sikurse tha edhe Viktori, nuk hedhim dot asgjë në letër, në lidhje me riformatimin aktual të KQZ-së, në qoftë se nuk e dimë çfarë doni. Për çfarë menduam se i shërben punës së komisionit, duke e prodhuar ne, me nismë teknike, e kemi paraqitur sot këtu.

Ne po punojmë edhe për variantin integral të këtyre, për komoditetin tuaj, që të mund ta lexoni të gjithën në një. Varianti integral do të përfshijë edhe dispozitat që ndryshojnë vetëm për motive teknike. Pra, ndryshon emërtesa, duhet të ndryshojë edhe fjala në dispozitë, që s'kanë përmbajtje në vetvete, që nuk kanë vlerë për diskutim. Do të jenë të gjitha në një trup të vetëm, dhe unë besoj se ju do ta keni shumë shpejt këtë material edhe në variantin integral.

Për t'iu përgjigjur pyetjes, kaq prodhojmë ne me nismën tonë. Sa i takon pjesës tjetër, jemi në dispozicionin tuaj. Për çfarëdolloj gjëje që ju do të na kërkoni, ne kemi vetëm vullnetin për të bërë më të mirën. Të jeni të sigurtë se ajo që kemi bërë me nismën tonë është më e mira e mundshme. Me nismën tonë, me sugjerimet dhe udhëheqjen tuaj, ndoshta mund të ketë ndonjë gjë që mund të bëhet më mirë.

Rudina Hajdari – Zoti Rusmajli, nuk ju përgjigjet pyetjes sime: ka një draft tjetër?

Illir Rusmajli – Vetëm integrali, domethënë materiali integral, që do të ketë ca nene të reja, por që nuk kanë vlerë teknike, sepse është vetëm ndryshim terminologjie. Atë po e përjasim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Kam edhe një pyetje tjetër: a i keni parë ankesat, opinionet apo rekomandimet e shoqërisë civile, sa u përket drafteve të para, pra draftit 1 dhe draftit 2? Në gjykimin tuaj, a duhet që ne t'i përfshijmë këto në dërgimin për opinion në ODIHR?

Illir Rusmajli – Faleminderit për këtë pyetje!

Ne do ta kishim paraqitur më shpejt integralin, sepse kemi punuar gjatë kësaj kohe, po procesi është vonuar pikërisht për shkak të nevojës, nga që duhej të konsultonim gjithë inputet e shoqërisë civile. Kemi bërë edhe takimin e veçantë me një pjesë të tyre, me ata që shprehën gatishmërinë për të ardhur. Mund të themi se ka qenë takim i frytshëm. Patëm mundësi jo vetëm të sqarojmë pyetjet që ata kishin, por patëm mundësi edhe të diskutonim me ta, patëm mundësi të mblidhnim edhe ide prej tyre.

I administrojmë dhe jemi duke i përqasur të gjithë dokumentet që ata kanë. Ndërkohë, një pjesë të sugjerimeve edhe i kemi reflektuar. Kemi modifikuar nga materiali i paraqitur fillimisht, por jo gjithçka. Kemi shtuar ose riformuluar fjali, të cilat u përgjigjen më mirë shqetësimeve të shoqërisë civile. Ndërkohë, këtë e kemi bërë për një pjesë. Do ta mbyllim edhe për pjesën tjetër, e do t'jua paraqesim.

Sigurisht, duhet të jemi në të vetëdijshëm, por edhe ju duhet ta keni këtë informacion: jo të gjitha idetë dhe sugjerimet janë të pajtueshme me atë që kemi. Ka ide, të cilat janë absolutisht të kundërta me draftin. Midis ideve të kundërta me draftin dhe draftit, ne kemi zgjedhur draftin, sepse është produkti ynë. Ju mund të zgjidhni të kundërtat e tyre, por të kundërtat e tyre do të thotë: bie ky draft, formatohet një draft tjetër.

Ne s'i kemi zgjedhur jo ngaqë preferojmë draftin, por në të gjitha rastet kur propozimet kanë qenë të kundërta, kanë qenë jo të argumentuara, jo bindëse, jo profesionale nga pikëpamja e teknikës juridike, prandaj nuk i kemi marrë në konsideratë. Të gjitha sugjerimet që janë inpute pozitive, një pjesë prej tyre i kemi marrë, një pjesë do t'i marrim këto dy ditë, duke u përpjekur t'i inkorporojmë në tekstin integral.

Rudina Hajdari – Në rregull!

Atëherë, në momentin kur ta keni gati këtë draft të ripunuar, duhet të na e dërgoni, që më pas të shikojmë një opinion jo formal në lidhje me të, dhe se si do të ecim përpara. Sepse, tërë problemi është që të kemi një draft të gjithëpranuar. Shoqëria civile duhet të ketë një rol shumë të rëndësishëm, sidomos në kushtet që jemi sot.

Keni ndonjë afat për këtë?

Ilir Rusmajli – Deri të hënën tjetër. Ne shpresojmë se më shpejt, po deri të hënën tjetër besoj se e kemi përfunduar. Shpresojmë ta bëjmë më shpejt, dhe sapo ta bëjmë, do t'jua nisim, se s'kemi pse e mbajmë.

Damian Gjijnuri – Natyrisht, këtu kanë ardhur inpute nga shoqëria civile, por nuk e di se sa nga ato janë me brumë, që mund të krijojnë mundësinë e një drafti paralel apo të një opinionit, por disa nga çështjet alternative që ata kanë ngritur, mund t'i bashkëlidhen propozimeve të draftit që do të nisë komisioni për një opinion.

Nga ana tjetër, dua të theksoj një gjë: të mos trembemi nga ideja e një opinionit paraprak, sepse, kur ia kemi nisur këto drafte për opinion të gjitha partive dhe të gjitha organizatave qeveritare, se marrim një opinion paraprak, para se të kalojmë në proces votimi apo miratimi këtu, nuk ka asgjë të keqe. Pse? E para, sepse është një shoshitje e nevojshme. E dyta, fokusohemi te disa çështje, për të cilat ODIHR-i mund të thotë: këto kanë nevojë për më shumë hulumtim, kanë nevojë për më shumë konsultim, pse jo edhe për propozime

alternative. Në fund fare, kur ta çojmë draftin final, pasi ta kemi miratuar, gjithnjë me proces votimi, në Komisionin e Reformës Zgjedhore, do të kemi një koment final para se të vendosim. Opinioni informal do të na ndihmojë për të qartësuar disa nga gjërat tona, pse jo edhe për t'u dhënë përgjigje opinioneve a propozimeve të ndryshme, që kanë ardhur nga shoqëria civile.

Kësisoj, unë mendoj se ato që janë me vlerë nga shoqëria civile, që mund të kenë ofruar metoda alternative të trajtimit të rekomandimeve, ju lutem t'i vendosni aty, në mënyrë që ta dimë që ODIHR-i thotë: të dyja qëndrojnë, por është diskrecion i komisionit për të vendosur; ose: drafti i shoqërisë civile, propozimi i shoqërisë civile i adreson më mirë rekomandimet e ODIHR-it. më pas, patjetër që ne do të marrim një vendim. Dakord?

Faleminderit!

Së bashku me bashkëkryetaren, do të përcaktojmë një datë për muajin janar, në lidhje me çështjet e sistemit zgjedhor, për të filluar edhe trajtimin e propozimeve që kanë ardhur.

Ju lutem, drafti t'u vihet në dispozicion ekspertëve, që ta shikojnë, të bëjnë një analizë dhe të fillojnë të punojnë me të.

Faleminderit shumë!

Ju uroj festa të mbara: Krishtlindjen dhe Vitin e Ri!

MBYLLET MBLEDHJA